



KOALICIONI "GËRMIA 2005"

04/02/2014

Shkeljet ligjore dhe administrative me rastin e ndërtimit të QAP-së në Gërmi

II. Shkelja e ligjshmërisë:

- Vendimi për Vënien nën Mbrojtje të Kompleksit "Gërmi", ("Gaz.zyr. e KSAK", Nr. 43, datë 26 dhjetor 1987, nga neni 1 - 9).
- Ligji për "Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Vlerave Natyrore dhe të Vlerave të krijuara me punë të ambientit të njeriut", ("Gaz.zyr e KSAK", Nr.39, i datës 29 dhjetor 1988, po thuajse të gjitha nenet, në veçanti neni 39, 40, 40.1-40.11, 41, 48, 82, 83, 84, 85, etj).
- Vendimi për mbrojtjen e Parkut Natyror Gërmi, ("Gaz Zyr e KSAKM", Nr 15, datë 30 dhjetor 1995, neni 1 - 13).
- Ligji për Planifikim Hapësinor, Nr.2003/14, neni 3, 5.1 ,5.2, 5.3, neni 13.1-13.9, neni 15, neni 17.1-17.4, neni 26.1-26.3.
- Ligji për Ndërtim i Kuvendit të Kosovës, Nr.2004/15, neni 33, neni 36, neni 37, 39.6.
- Rregullore mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve, i Kuvendit Komunal të Prishtinës, Nr. 01-010-3 i dt. 03.01.2002, neni 6, neni 9, neni 31, neni 45, neni 47.
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, i Kuvendit të Kosovës, i dt. 16 janar 2003, neni 4; 5.b; 8; 18; 20.1-20.7; 20.1-20.8; 22; 23; 27; 29; 33 dhe 34.
- Udhëzimi Administrativ nr.XX/2004 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, draft 8 korrik 2004.
- Ekstrakt nga "Plani Strategjik- Zhvillimi Urban i Prishtinës 2004-2020" i miratuar nga Asambleja Komunale e Prishtinës në vitin 2004.
- Tabela e Zonave të Mbrojtura të Kosovës, (në faqen e fundit Parku Regjional "Gërmi").

III. Shkeljet e procedurës administrative:

- Fleta Poseduese nr.168, dëshmon se titullar i shfrytëzimit të tokës është ish Këshilli Elzekutiv i Kosovës, përkatësisht Qeveria e Kosovës, andaj kërkesa e Administratës së Kuvendit të Kosovës për rindërtim të objekteve të shkatërruara nga bombardimet e Natos, konsiderohet inkopetente:
 1. paraprakisht Kuvendi i Kosovës nuk ka marrë vendim për bartje të ligjshme të pronësisë, të cilën njekohësisht e ka kërkuar edhe Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtimtari.
 2. Kuvendi i Kosovës është vetëm organ legjislativ i cili e prodhon dhe e kontrollon ligjshmërinë duke bërë në forma të ndryshme monitorimin e organeve ekzekutive dhe të tjera, e jo të merrë me çështje ekzekutive të cilat i takojnë ekskluzivisht Qeverisë.
- Kërkesa e Kuvendit të Kosovës drejtuar Kuvendit Komunal të Prishtinës e cila dëshmon se Kuvendi i Kosovës ka kërkuar leje për rindërtim e jo për ndërtim të ri, datë 28.06.2005
- Shkresa e Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtimtari i Komunës së Prishtinës 05 Nr 350-228 dt 21.04.2004, drejtuar Kuvendit të Kosovës, që ky i fundit me qëllim të zbatimit të drejtë të rregullativës ligjore nga lëmia e planifikimit hapsinor ... duhet të nxjerr ndonjë vendim në bazë të të cilit do të mund të bëhej ndryshimi në evidencat kadastrale mbi të drejtën e shfrytëzimit të këtyre ngastrave, megjë Kuvendi i Kosovës nuk është titullar i tokës
- Aktvendimi i Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtimtari të Prishtinës 05 Nr.350-8645 Dt. 19.04.2005 në të cilin këtij të fundit i lejohet zhvillimi i punëve paraprake, përgatitore për fillimin e ndërtimit të objektit në ngastrat për të cilat ky i fundit nuk ka bërë kërkesë. Në këtë dokument shihet çartë manipulimi me Listat Poseduese, thuhet lista poseduese nr 168 kurse përmenden ngastrat e Listës Poseduese nr 153

● **Vendimi i Kuvendit Komunal të Prishtinës** Nr01-351-501/1 Dt. 04.02.2005, mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit – QAP në kompleksin Gërmia në Prishtinë, ku sipas nenit 3 bëhet ndërrimi i parcelave në mes dy Kuvendeve (Kuvendi i Kosovës dhe ai Komunal i Prishtinës) të cilët nuk janë titullar të ligjshëm të asnjërës parcelë, sepse sipas evidencës Zyrtare kadastrale F.P. Nr 168 titullar i par. Kadastrale 233/1 dhe 265 është ish Këshilli Ekzekutiv, tani Qeveria e Kosovës, ndërsa sipas F.P Nr. 153 titullar i ngastrave 264 dhe 169 është Ndërrmarrja Shoqërore Hortikultura.

● **Leja Urbanistike** 05 Nr.351-591 dt. 22.10.2004, e lëshuar nga Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimitarisë së Kuvendit të Prishtinës, dëshmon:

1. për ndërrim të ngastrave nga 168 në 153, bile edhe për ngatërrim të numrave të listave poseduese. Në pikën III flitet për listën poseduese Nr 168 me ngastrat 264 dhe 269 e cila nuk është e saktë sepse lista poseduese 168 ka ngastrat 233 dhe 265, kurse lista poseduese 153 ka ngastrat 264 dhe 269. Kjo përzjerje e numrave të listave poseduese dhe ngastrave dyshojmë se është bërë më qëllim.

2. Ligji mbi Planifikim Hapsinor Nr.2003/14 nuk njih kushte preliminare urbanistike-teknike, por, vetem kushte të përhershme apo të përkohshme të ndërtimit.

3. Drejtorati për P.U.N i KK. Prishtinës, sipas pikës 3 të Lejës Urbanistike të lartpërmendur, ka përcaktuar dislokimin e objektit pa i pasur kompetencat për këtë, sepse këtë të drejtë sipas ligjeve në fuqi e ka vetëm Kuvendi Komunal i cili pas tre muajsh ka miratuar propozimin e Drejtoratit (dëshmi: krahasimi i datave të Lejës Urbanistike dhe Vendimit të Kuvendit Komunal të Prishtinës Nr 01-351-591/1 dt.04.02.2005

● **Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, Instituti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës**, ka dhënë mendimin profesional dhe pëlqimin në lidhje me ndërtimin e Objektit, në kundërshtim me ligjet e lartpërmendura edhe pse sipas tyre vendimi i marre bazohet në Ligjin për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Vlerave Shoqërore dhe të Vlerave të Krijuar me Punë të Njeriut (“GZK” 39/88) dhe në Vendimin nr.110-117/87-01 të datës 19 nëntor 1987, të cilat ligje nuk parashohin ndërtimin e objekteve administrative, përkundrazi mbrojnë Parkun nga ndërtimet e tilla.

● **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**, përkatësisht dikush në emër të Sekretarit të Përhershëm të kësaj Ministrie ka dhënë “pëlqimin ekologjik” duke u thirrur në nenin 18 dhe 48 të (“GZK” 39/88).

1. Nënshkrimi në emër të Sekretarit të Përhershëm të Ministrisë pa autorizim është i kundërligjshëm.

.. Pëlqimi Ekologjik i Ministrisë është dhënë në kundërshtim me vetë dispozitat e nenit 48 të ligjit të lartpërmendur, pasi që i njëjti nen nuk parasheh veprimtari joekonomike ku në këtë lomenklaturën bënë pjesë Qendra Administrative Protokolare

● **Fleta Poseduese nr.153**, dëshmon se vendi ku aktualisht po ndërton Kuvendi i Kosovës, titullar i shfrytëzimit të tokës është Ndërrmarrja “Hortikultura”, tipi i pronës: shoqërore, me të cilën pronë menaxhon AKM-ja. Në këtë rast pëlqimi është dashur të ipet nga ky institucion, ose në variantin tjetër, nëse ndërrmarrja Horlikultura administrohet nga Komuna, atëherë për dhënien e tokës komunale në shfrytëzim deri në 10 vjet duhet të mirret pëlqimi paraprak nga përfaqësuesi Komunal i UNMIK-ut, kurse në rastet mbi 10 vjet duhet të merret pëlqimi i PSSP-së.

Në rastin konkret nuk është dhënë asnjë pëlqim, qoftë nga AKM-ja apo PSSP-ja, që paraqet shkelje drastike të ligjshmërisë dhe si rezultat Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtimtari nuk ka guxuar të lëshojë një lejë të tillë pa pëlqimin e UNMIK-ut

KUJDES:

MOS LEGJITIMONI SHKELJET

THUANI STOP NDERTIMEVE TE PALIGJSHME NE PARKUN REGJIONAL TE GERMISE!